



PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS-PREBK

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur

01 Janar 2023 - 31 Dhjetor 2023

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur.....	3-5
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Informata të përgjithshme	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	8 - 13

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së SP- Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, Prizren

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i opinionit

Ne kemi qen të angazhuar për të audituar raportet financiare bashkëngjitura të Subjektit Politik **“Partia Rome e Bashkuar e Kosovës Prizren-PREBK”** (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “PREBK”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2023, Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë , dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në faqet nga 8 deri 13.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të vitit 31.12.2023 të subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës Prizren-PREBK . Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të patur një bazë për një opinion të auditimit.

Baza për Mohim të Opinionit

- Subjekti Politik nuk ka prezantuar drejt pasurinë, ekuitetin dhe detyrimet me 31 Dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, po ashtu shënimit e prezantuara në Pasqyra e pozitës Financiare shënimi 5 Toka ,objektet dhe Pajisjet në vlere prej 1,500.00 Euro (viti:2022 vlere prej 2,000.00 Euro) janë pasqyruar gabimisht dhe nuk mbështeten me dëshmi relevante lidhur me zërat e pasqyrave financiare të SP me 31 Dhjetor 2023 ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058, Neni 15 Raportimi Financiar. Pas parasysh natyrën e shënimeve që mban subjekti politik ne e kishim të pamundur të përcaktojmë korrigjimet e nevojshme tek pasuria fikse me 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022.
- Subjekti Politik edhe pse ka shfrytëzuar lokalit për zyre gjate vitit 2023, e të cilën vlerë nuk e ka pasqyruar fare si “të hyra nga kontributet në natyrë, në mallëra dhe shërbime” por as si shpenzime nga qiraja. Zyra nuk është në pronësi të SP por që e ka shfrytëzuar të drejtën për shfrytëzim e zyrës nga një Organizata Joqeveritare (OJQ) dhe me të cilën nuk ka kontratë të arritur në mes palëve. Në mungesë të dokumentacionit mbështetës ne e kishim të pamundur të verifikojmë vlerën të cilën SP e ka pranuar si kontribut në emër të shfrytëzimit të objektit me qira nga qiradhënësi (kontributdhënësi) si e drejtë për shfrytëzimin e zyrës. Duke pasur parasysh natyrën e shënimeve që mban subjekti politik, ne e kishim të pamundur të përcaktojmë korrigjimet e nevojshme lidhur me vlerën e qirasë si dhe vlerën e kontributeve në natyrë në mallëra dhe shërbime me 31 dhjetor 2023.
- Subjekti politik nuk ka ofruar dëshmi mbështetëse për të hyrat dhe shpenzimet lidhur me aktivitetin e ushtruar gjate vitit për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023, prandaj ne nuk ishëm ne gjendje të japim një opinion për pasqyrat financiare dhe nuk e kishim njohurin se cilat do ishin transaksionet lidhur me shpenzimet e njohura në pasqyrën e të ardhurave e që kjo nuk është në pajtueshmëri me ligjin Nr. 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058, Neni 15 Raportimi Financiar. Pas parasysh natyrën e shënimeve që mban subjekti politik ne e kishim të pamundur të përcaktojmë

korrigjimet e nevojshme tek pasuria fikse me 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022. Duke pasur parasysh natyrën e shënimeve dhe evidencave kontabël që mban subjekti politik, ne e kishim të pamundur të përcaktojmë korrigjimet e nevojshme lidhur me vlerën e të hyrave dhe shpenzimeve ose edhe vlerën e kontributeve në natyrë në mallëra dhe shërbime me 31 dhjetor 2023.

Theksim i çështjes

Ne po ashtu tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve të raportimit financiar të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të mbrendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Raporti vjetor i dorëzuar në KQZ, si Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve vlera e shpenzimeve prej 15,613.96 Euro nuk është e përputhur me raportin e auditimit për vitin 31 dhjetor 2022 si dhe vlera e deficitit të pasqyruar në raportin e auditimit me 31 dhjetor 2022 nuk është pasqyruar në balancën e hapjes me 1janar 2023 tek fondet e akumuluar.

Çështje tjera

Pasqyrat financiare të subjektit politik për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2022 janë audituar nga auditor tjetër opinioni i të cilëve mbi këto pasqyra ka qen i mohuar për çështjen e prezantimit jo të drejt të pasqyrave financiare dhe mungesës së dokumentacionit mbështetës.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Muhamet Feka
Auditore Ligjor
21 Qershor 2024

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2023	Me 31 Dhjetor 2022
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	5	1,500.00	2,000.00
Pasuritë e paprekshme		0.00	0.00
Pasuritë tjera afatgjata		0.00	0.00
Total pasuritë afatgjata		1,500.00	2,000.00
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme			
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	6	0.00	0.00
Pasuritë tjera afatshkurtra	7	0.00	0.00
Total pasuritë afatshkurtra		0.00	0.00
Total pasuritë		1,500.00	2,000.00
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		0.00	0.00
Suficiti / (deficiti) i vitit		0.00	0.00
Total Ekuiteti		0.00	0.00
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme		0.00	0.00
Të hyrat e shtyera	8	1,500.00	2,000.00
Gjithsej detyrimet afatgjata		1,500.00	2,000.00
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera		0.00	0.00
Huatë e pagueshme		0.00	0.00
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	0.00	0.00
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		0.00	0.00
Gjithsej detyrimet		1,500.00	2,000.00
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		1,500.00	2,000.00

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2023	2022
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		0.00	0.00
Të hyrat nga anëtarësia		0.00	0.00
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	0.00	0.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4	0.00	0.00
Të hyrat e fushatës		0.00	0.00
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera		0.00	0.00
Të hyrat tjera		0.00	0.00
Gjithsej të hyrat për vitin		0.00	0.00
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	2	0.00	2,367.96
Shpenzimet e transportit	2	0.00	0.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	0.00	0.00
Shpenzimet e fushatës	2	0.00	13,246.00
Blerja e mallrave	2	0.00	0.00
Shpenzimet e përgjithshme	2	0.00	0.00
Shpenzimet e ndryshme	2	0.00	0.00
Gjithsej shpenzimet për vitin		0.00	15,613.96
Suficiti / (deficiti) për vitin		0.00	(15,613.96)

1. Informata te përgjithshme

PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVES-PRBEK

Udhëheqja: Albert Kinolli -Kryetar i partisë
Përfaqësues i autorizuar financiar – Armend Kinolli

Selia e partisë: Zahir Pajaziti Nr. 7 Prizren
Pasqyrat financiare të SP Partia Rome e Bashkuar e Kosovës -PRBEK janë përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 10 të Ligjit 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058, Subjekti i regjistruar politik brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

SP ka aktive një llogari rrjedhëse bankare e hapur në Bankën për Biznes në Prishtinë qysh nga viti 2020 dhe e cila ka status aktiv deri në kohën e pregaditjes të këti draft raporti.
Një llogari tjetër me status të ngrirë e ka gjithashtu në Bankën për Biznes nga data e azhurnimit 05.03.2024.Gjithashtu në Banken Raiffaisen Bank ka një llogari rrjedhëse me status jo aktiv e cila është hapur nga data 26.07.2005.

Shënimi 2. Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	0.00	0.00	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	0.00	0.00	0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit	0.00	0.00	0.00
Tatimet në të ardhura personale	0.00	0.00	0.00
Beneficionet tjera	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara	0.00	0.00	0.00
Karburantet	0.00	0.00	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	0.00	0.00	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	0.00	0.00	0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit	0.00	0.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	0.00	0.00	0.00
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali	0.00	0.00	0.00
Ushqimi	0.00	0.00	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative	0.00	0.00	0.00
Radio dhe spotet televizive	0.00	0.00	0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	0.00	0.00	0.00
Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e fushatës			

Shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	0.00	0.00	0.00
Pajisjet të vogla	0.00	0.00	0.00
Gjithsej blerja e mallrave	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	0.00	0.00	0.00
Telefoni, interneti dhe posta	0.00	0.00	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë		////////////////////	////////////////////
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime		////////////////////	////////////////////
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	0.00	0.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	0.00	0.00	0.00
Gjithsej shpenzimet	0.00	0.00	0.00

Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga				Vlera	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro	Bankë	Arkë
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				0.00	0.00	0.00

Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga				Vlera
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					0.00

Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fund të vitit (vlera neto)
Toka					0.00
Objektet	1,500.00				1,500.00
Veturat					
Pajisjet e zyrës					
Pajisjet e teknologjisë informative					
Pajisjet tjera					
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	1,500.00				1,500.00

Shënime tjera

Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme	Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
.....		
.....		
Gjithsej Llogarit e arkëtueshme	0.00	0.00

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
Paraja në bankë		
Paraja në arkë		
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	0.00	0.00

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
.....furnitori 1		
.....furnitori 2		
.....furnitori 3		
.....furnitori 4		
Llogari te pagueshme te tjera		
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	0.00	0.00

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra	Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime		
Detyrimet për qira		
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)		
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	0.00	0.00

Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

	Paguar ndaj:				Vlera
Qëllimi i pagesës	Përsoni Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal	Data kur është bërë pagesa	në euro
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro					0.00